

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K., TRINGË SMAJLI – PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	24.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **23.10.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **17.10.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **17.10.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **23.10.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET E TUA ANKIMORE:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Me datë: 05.10.2023, në ora: 12:16 h, me Formular: B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit:

Dërguar në: Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K., " AS ...

B47 Letër Standarde e kërkeses për sqarimin e tenderit

B47 Letër Standarde e kërkeses për sqarimin e tenderit - AS Tech SH.P.K. - Prishtinë.pdf

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

Ngarko:

Shqip

Srpski

English

Dërgo

05.10.2023 12:16

Duke u mbështetur në VENDIMIN e OSHP-së Nr. 2023/0509, kemi kërkuar nga ana juaj sqarimet për këto dokumentet:

Pra në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, përkatësisht të nenit 72 kërkoj sqarime shtesë si në vijime:

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, me VENDIM për pozitën:

2

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, **keni prezantuar z. Bekim Mustafa**;

Ndërsa për pozitën: 2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, **me VENDIM, keni prezantuar z. Fatos Sahatqija**;

Por në Ofertën e dorëzuar, nuk keni prezantuar, dokumentet e kërkuara të Kërkesës Nr. 2, përkatësisht sipas Dëshmisë 2 të kërkuar dokumentare:

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);**

- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**

- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**

- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**

*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet **ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.***

*Si dëshmi për Inxhinieret duhet te ofrohet **kontrata** dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca ofrimit të **para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve**, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë **objektive.***

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën:

Një (1) një person te trajnuar dhe certifikuar nga fusha e sigurisë dhe shëndetit ne pune, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, keni prezantuar:

Afrim Sadiki; Valdet Sadiki; Fahri Sadiki; Bekim Sadiki; Jetmir Sadiku; Daut Sadiku; Gëzim Zeqiri; Shpejtim Xhemaj; Shkëlqim Fetahaj;

Por në Ofertën e dorëzuar, nuk keni prezantuar, dokumentet e kërkuara të Kërkesës Nr. 2, përkatësisht sipas Dëshmisë 2 të kërkuar dokumentare:

- **Diploma apo Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;**

- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**

- **Kontrata valide ose Para-kontrata e punës për stafin profesional;**

*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet **ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.***

*Si dëshmi për personat duhet te ofrohet **kontrata** dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca ofrimit të **para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve**, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë **objektive.***

VËREJTJE: Neni 72, paragrafi 3. thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet **ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.**


Përgjigja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues apo në e-mailit:

[prokurimi.rahovec@gmail.com] brenda [5 ditëve] nga data e kësaj kërkesë, përkatësisht deri me datë: **09.10.2023**, në ora: **14:00 h.**

Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Me datë: **09.10.2023**, në ora: **13:52 h**, nëpërmjet Sistemit të prokurimit elektronik, kemi pranuar Kërkesë nga ana juaj për shtyerjen e afatit për kthimin e përgjigjes (tetë (8) minuta para përfundimit të afatit kohor për sqarimin e tenderit):

Dërguar nga : " AS Tech " SH.PK.	09.10.2023 13:52
Dokumenti për dërgim të AK	
Scan_20231009 (19).pdf	09.10.2023 13:52
Hape:	Shqip



Me datë: **09.10.2023**, në ora: **15:29 h**, me Formular: B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit:

Dërguar në: Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K., " AS ...		✓ ✓
B47 Letër Standarde e kërkeses për sqarimin e tenderit		
B47 Letër Standarde e kërkeses për sqarimin e tenderit - AS Tech SH.P.K. - Prishtine.pdf		09.10.2023 15:29
Hape:	Shkarko të gjithë dokumentacionin Shqip 📅 👤	
Ngarko:	Shqip Srpski English	
		Dërgo

Kemi dërguar këtë sqarim, duke cekur:

Te nderuar;

Fatkeqësisht kërkesa për shtyrje të afatit kohor në ofrimin e dokumenteve të kërkuara nga AK, nuk mundet të mirëtohet për bazë.

Për dokumentet e kërkuara nga AK, në bazë të nenit 72, ju si Operator Ekonomik keni potencuar në Kërkesën për rishqyrtim po ashtu edhe në Ankesën e parashtruar në OSHP, që i keni të gatshme dhe mos ofrimi i tyre me ofertë ka ndikuar në kapacitetin e tyre të lartë, gjë që sipas juve ka qenë të pamundur të ngritën në platforme, saktësisht keni cekur:

“Në oferte ne kemi dorëzuar Listën e punëtorëve dhe Vendimet për menaxher të projektit dhe udhëheqës se punishtes por për shkak të vëllimit të dokumentacionit për shkak të kapacitetit të kufizuar të ngarkimit të dokumenteve në sistem dhe kohës së shkurtër nuk i kemi ngarkuar dokumentet tjera, ekzistenca e të cilave ka datuar edhe atë ditë por që kemi qenë të vetëdijshëm se AK pastaj mund të kërkojë sqarime, siç bëjnë të gjitha AK tjera”.

Për këtë arsyeje Autoriteti Kontraktues, kërkesën tuaj e konsideron si të pa arsyeshme dhe nuk mund të merr për bazë.

Autoriteti Kontraktues, ka dhënë afat të mjaftueshëm për sqarimin ose sjelljen e dokumenteve të kërkuara.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë tutje me Rivlerësim, për Operatoret tjerë konkurse.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Në Kërkesën tuaj për rishqyrtim e datës 23.10.2023, në Pretendimin tuaj ankimor keni cekur: *Menjëherë pas paraqitjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues, me letër sqarim kemi kërkuar që ky kemi kërkuar që ky afat të zgjatet pasi që është i shkurtër dhe duke e ditur që është kërkuar një dokumentacion i gjere duhet kohe vetëm në kompletimin e dokumentacionit kur dihet që jemi të angazhuar si kompani edhe në projekte tjera*

Ku në kërkesën tuaj për ri zgjatje të afatit keni cekur:

Letren standarte që kemi pranuar nga ana juaj, kërkojmë të na mundësoni shtyerjen e afati për kthimin e përgjigjes deri në 10.10.2023 për shkak se shëndetësorë nuk gjindemi në zyrë, kërkojmë mirëkuptimin tuaj,

Ndërsa në Kërkesën për rishqyrtim e datës: 10.07.2023, keni cekur:

Ofertat juaja dhe tenderi nuk është vlerësuar si duhet përderisa AK nuk e ka respektuar nenin 10 të Udhëzuesit nr 001/2023 i prokurimit publik: Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

LPP thotë që AK mund të kërkojë sqarime për dokumentet ekzistenciale para hapjes, në kemi dorëzuar Listën e punëtorëve dhe Vendimet për menaxher të projektit dhe udhëheqës se punishtes por për shkak të vëllimit të dokumentacionit për shkak të kapacitetit të kufizuar të ngarkimit të dokumenteve në sistem dhe kohës së shkurtër nuk i kemi ngarkuar dokumentet tjera, ekzistenca e të cilave ka datuar edhe atë ditë por që kemi qenë të vetëdijshëm se AK pastaj mund të kërkojë sqarime, siç bëjnë të gjitha AK tjera.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar

Po ashtu në Kërkesën tuaj për rishqyrtim e datës 23.10.2023, keni cekur: Pra, vendimi i juaj ka qenë i shkruar një muaj më parë dhe se kërkesa për dokumentacion ishte një kamuflim i radhës edhe se nuk na është dhënë afati i nevojshëm për plotësimin e dokumentacionit.

Për këtë qështje mundet shumë lehtë të verifikohet në sistemin e prokurimit elektronik:

B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues

028 - Njoftim Mbi Vendimin e AK si dhe Letrat standarde për OE..pdf

17.10.2023 10:12

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip



Po ashtu keni cekur: Ju si AK nuk keni dhënë asnjë dëshmi se keni vepruar në harmoni me vendimin e OSHP-së me Nr. 2023/0509, ku ndër të tjerash në vendim thuhet;

Në se AK: Komuna e Rahovecit, e kemi respektuar plotësisht vendimin e OSHP-së Nr. 2023/0509

Para kontratat e dorëzuar tuaj për Kërkesë për rishqyrtim e Inxhinierëve të prezantuar janë të datës: **23.05.2023**, ku janë me të njëjtën datë me datën e hapjes së ofertave dhe janë në kundërshtim me Paragrafin 3 të Nenit 72 të LPP – së, ku thotë:

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, **para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve**, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit